



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01Nr 06/01-11/54
Datë 04.05.2022

Komuna e Gjakovës, duke u bazuar në nenin 68 paragrafi 68.3 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, nenin 65 të Statutit të Komunës së Gjakovës, si dhe nenit 14 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, me datën 04.05.2022, publikon këtë:

NJOFTIM

Komuna e Gjakovës, organizon konsultim publik me qytetarët e Komunës së Gjakovës, me bizneset e komunës dhe personat tjerë të interesuar lidhur me: Hartimin e Rregullores për Taksat Komunale.

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale në Komunën e Gjakovës, lartësinë e taksave komunale, përcaktimin e kategorive të liruara nga kjo taksë dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Kopja fizike e Rregullores për Taksat Komunale mund të sigurohet në zyrën informative për qytetarët në objektin e Komunës së Gjakovës çdo ditë pune prej orës 10:00 deri në ora 14:00, duke filluar nga data 04.05.2022 si dhe në web faqen e Komunës së Gjakovës <https://kk.rks-gov.net/gjakove/kuvendi/draft-rregulloret/>

Takimi publik mbahet me datën 02.06.2022 në sallën e Kuvendit të Komunës së Gjakovës (ish ndërtesa e Bankosit), me fillim në ora 10:00.

Qytetarë të nderuar është në interesin tuaj që të merrni pjesë në këtë takim dhe të kontribuoni drejtpërdrejtë për miratimin e kësaj rregullore, përmes pyetjeve, vërejtjeve apo komenteve tjera me të cilat mund t'iu drejtoheni drejtpërdrejtë në debat apo me shkrim përmes e-mailit: frok.gjergjaj@rks-gov.net

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

